

4. Të analizohet ndarja e teksteve

kl. 4-9

30 min.



Materiali:
Tekste (shih djathtas)

Varianti 1: N marrin një ose disa tekste (tekste me rrjedhë të qartë kronologjike!) si dhe një fletë, në të cilën e vizatojnë një rreze kohore (krah. nr. 9). Pastaj ata duhet që stacionet veç e veç të tekstit t'i shënojnë në mënyrë të përmbledhur në rreze kohore.

Varianti 2: N marrin tekste me kërkesa të larta të llojeve të ndryshme dhe duhet që t'i shënojnë me ngjyra të ndryshme së paku tri pjesët hyrjen / pjesën kryesore / përfundimin, përmbledhjen.

5. Për një fillim të gjendet një fund dhe anasjelltas; «Tregimet-Sandwich»

kl. 2-9

30 min.



Materiali:
Fletë me fillime tekstesh

Nxënësit e marrin fillimin e një teksti (p.sh. fillimin e një tregimi ose hyrjen e një artikulli nga gazeta). Individualisht ose në grupe dyshe ose treshe duhet të shkruajnë tekstin deri në fund dhe gjithashtu gjatë kësaj pune të shënohen edhe pjesët si pjesa kryesore dhe përfundimi/përmbledhja. Tek tekstet e gjata duhet të vënë mestituj. Në vazhdim ata e paraqesin tekstin e tyre para të tjerëve. Kjo është interesante sepse të gjithë e kanë të njëjtin fillim dhe tekstet dalin megjithatë krejt të ndryshme.

Varianti 1: N e marrin fundin e një teksti dhe duhet të shkruajnë fillimin dhe pjesën kryesore.

Varianti 2: «Tregimet Sandwich»: N marrin fillimin dhe fundin e një teksti (tregim, shaka, tekst tematik) dhe duhet të sajojnë pjesën e mesme.

6. Rregullat e lojës, udhëzimet për punë dore, recetat të shkruhen dhe të mblidhen

kl. 2-9

40 min.



Përpilimi i teksteve me veprime orientuese si rregullat e lojës, udhëzimet për punë dore, recetat etj. kërkon një ndërtim veçanërisht të qartë, sepse në të kundërtën udhëzimet janë vështirë të kuptueshme ose s'kuptohen fare. Kualiteti i një teksti të tillë lejon që të matet menjëherë se sa mirë ai «funksionon». Të vendosen me klasën mbledhja e recetave, udhëzimeve për punë dore etj. është njëkohësisht një projekt atraktiv, sepse këto tekste janë për përdorim të drejtpërdrejtë praktik. Atraktive janë edhe përmbledhjet dygjuhësore në bashkëpunim me mësime të mësimdhënësit e mësimimit të rregullt, shih më poshtë nr. 21.